

# KLASAT E FJALËVE TË PANDRYSHUESHME

## NDAJFOLJA

- **Ndajfoljet e mënyrës** tregojnë mënyrën se si kryhet një veprim. Ato janë: *ashpërsisht, barkas, besnikërisht, bujarisht, bukur, burrërisht, cekët, djallëzisht, dhelpërisht, egërsisht, ëmbël, fizikisht, fuqishëm, furishëm, gëzueshëm, gjallërisht, gjatë, gjerë, haptazi, hareshëm, heroikisht, hollë, hollësisht, imtësisht, keq, lehtë, lehtësisht, mbarë, me hir, me pahir, me të mirë, me zor, mendueshëm, menjëherë, mirë, natyrshëm, ngadalë, ngultas, nxitimthi, pa të drejtë, pa të keq, pak nga pak, papandehur, papritur, pastër, përzemërsisht, pjesërisht, plegërisht, qartë, qenërisht, qetë, rastësisht, rëndon, rrjedhshëm, shkurt, shpesh, shterueshëm, shtrembër, teorikisht, trimërisht, thellë, thjesht, thjeshtësisht, ulët, ushtarakisht, vazhdimisht, vështirë, vullnetarisht, zyrtarisht etj.*
- **Ndajfoljet e sasisë** tregojnë shkallën e kryerjes së një veprimi. Të tilla janë: *aq, kaq, shumë, pak, mjaft, tepër, më, një herë, dy herë, njëfish, dyfish, pesëfish etj.*
- **Ndajfoljet e vendit** tregojnë vendin ku kryhet një veprim. Ato janë: *afër, andej, anekënd, anembanë, asgjekund, atje, aty, brenda, diku, djathtas, gjekund, gjithandej, jashtë, këndej, këtu, kudo, larg, lart, majtas, mënjandë, në të djathtë, ngado, para, përjashta, përpara, përtej, poshtë, pranë, prapa, rreth, sipër, tekdo, tutje, vende-vende etj.*
- **Ndajfoljet e kohës** tregojnë kohën e kryerjes së një veprimi. Ndajfolje kohe janë: *askurrë, asnjëherë, ditë për ditë, aty për aty, dendur, dikur, ditë për ditë, dje, gjatë, gjithmonë, gjithnjë, herë pas here, herët, javë për javë, kohë pas kohe, kurdoherë, kurrë, mbrëmë, menjëherë, mot, motmot, natë për natë, ndonjëherë, nesër, nganjëherë, një çikë, një herë e një kohë, një hop, një moti, njëherë, njëherë përnjëherë, pak, paradite, pardje, parmbremë, parvjet, pasdite, pasdreke, pasnesër, pastaj, përditë, rrallë, së lashti, së shpejti, sonte, sot, sot për sot, shpejt, shpeshherë, tani, vjet, vonë etj.*
- **Ndajfoljet e shkakut** shërbejnë për të treguar a për të pyetur për shkakun e kryerjes së një veprimi dhe janë: *përse, pse, prandaj, andaj.*

## PARAFJALA

Parafjalët e rasës **emërore** janë: *nga, te dhe tek.*

Parafjalët e rasës **gjinore** janë: *me anë, me anën, në drejtim, për punë, në sajë, për shkak etj.*

Parafjalët e rasës **kallëzore** janë: *në, me, për, pa, më, mbi, nën, ndër, nëpër, bashkë me, tok me, me gjithë, në krahasim me, në lidhje me, në pajtim me, në përshtatje me etj.*

Parafjalët e rasës **rrjedhore** janë: *prej, ndaj, anë, majë, buzë, afër, krahas, larg, përveç, sipas, me anë, në mes.*

# LIDHËZA

## 1. Lidhëza bashkërenditëse

Lidhëzat bashkërenditëse ndahen në disa grupe. Ato janë:

**Lidhëza këpujore:** *as, dhe, e, edhe, si... edhe, hem... hem, si... si, si... ashtu (e)dhe, as, dhe, as... as, dhe... dhe, edhe... edhe* etj.

**Lidhëza veçuese :** *a, apo, o, ose, daç... daç, ja... ja, ndo... ndo, qoftë... qoftë, o... o, ose... ose* etj.

**Lidhëza kundërshtore:** *kurse, megjithatë, megjithëkëtë, mirëpo, ndërsa, teksa, po, por, porse, veç, veçqë, veçse, vetëm, vetëm se* etj.

**Lidhëza përmbyllëse:** *andaj, ndaj, pa, prandaj.*

**Lidhëza të shkallëzimit:** *jo që... po, jo që... po(r) edhe, jo veç (që)... por edhe, jo vetëm (që)... por, jo vetëm (që)... por as, jo vetëm (që)... por edhe, jo vetëm (që)... porse, le që... por, le që... por as (që), le që... por edhe.*

## 2. Lidhëzat nënrenditëse

Lidhëzat nënrenditëse ndahen në disa grupe. Ato janë:

**Lidhëzat fthilluese:** *se, që, në, nëse.*

**Lidhëza vendore:** *ku, tek, nga, kudo, ngado, tekdo, deri ku, gjer ku, nga ku, që ku, kudo që, ngado që, tekdo që* etj.

**Lidhëza kohore:** *kur, sa, si, tek, që, derisa, gjersa, pasi, mbasi, ndërsa, porsa, qëkurse, sapo, teksa, kurdo që, kurdoherë që, para se, posa që, që kur, që se, qysh se, sapo që, sa herë që* etj.

**Lidhëza shkakore:** *se, sepse, si, pasi, derisa, gjersa, përderisa, kur, që, sapo, meqenëse, meqë, ngaqë, ngase, prejse, duke qenë se, nga frika se, nga shkak që, për arsye se, për shkak se, posa që, sapo që* etj.

**Lidhëza qëllimore:** *që, me qëllim që, në mënyrë që.*

**Lidhëza krahasore-mënyrore:** *sa, se, si, sesa, porsi, sikurse, sikundërse, ashtu siç* etj.

**Lidhëza kushtore:** *në, po, nëse, kur, sikur, në qoftë se, në është se, në rast se, po qe se, me kusht që* etj.

**Lidhëza rrjedhimore:** *sa, saqë, që, aq sa, kështu që.*

**Lidhëza lejore:** *megjithëse, megjithëqë, ndonëse, sado që, edhe në, edhe në qoftë se, edhe po, edhe pse, edhe sepse, edhe sikur.*

**Lidhëza kundërvënëse:** *në vend që.*

## 3. Lidhëza shpjeguese a sqaruese

Lidhëzat shpjeguese janë: *bie fjala, për shembull, apo, si, siç.*

## PJESËZA

### 1. Pjesëza që shprehin ngjyrimë kuptimore të përgjithshme

Pjesëza që shprehin ngjyrimë kuptimore të përgjithshme janë:

**Pjesëza dëftuese:** *ja*.

**Pjesëzat përcaktuese-saktësuese:** *bash, deri (gjer), mu, pikërisht, plot, po, porsa (posa), që, qysh, rrumbullak, sa, sapo* etj.

**Pjesëzat përforcuese:** *bile, dhe, edhe, madje, sidomos, veç, veçse, vetëm, veçanërisht bile, dhe, edhe, madje sidomos, veç, veçse, veçanërisht, vetëm* etj.

**Pjesëzat përfruese:** *afërsisht (afro), aty-aty, nja, si nja, gati, rreth, thuajse (pothuajse), desh, mend* etj.

### 2. Pjesëzat modale

Pjesëza modale janë:

**Pjesëzat pohuese:** *po, posi, po që po, po se po, si urdhëron* etj.

**Pjesëzat mohuese:** *jo, mos, nuk, s', jo që jo, jo se jo, as që* etj.

**Pjesëzat dyshuese:** *gjë, kushedi, mbase, ndoshta, sikur, vallë* etj.

**Pjesëzat zbutëse:** *pa, as, le, para, dot* etj.

### 3. Pjesëzat emocionuese-shprehëse

Pjesëza emocionuese-shprehëse janë: *ç', de, pa, pale, pra, se, seç* etj.

## PASTHIRRMA

### 1. Pasthirrat emocionuese

Pasthirrma që shprehin ndjenja të gëzuara: *ëhëhë, o, oh, oho, hoho, ohoho, të lumtë, urra* etj.

Pasthirrma që shprehin habi: *au, eu, oj, ou, pa, u, ua, uh* etj.

Pasthirrma që shprehin frikë, dëshpërim, hidhërim: *bobo, bubu, korba, kuku, obobo, qyqja, ububu, e zeza* etj.:

Pasthirrma që shprehin mosbesim, mospërfillje, përbuzje: *aha, bah, ehe, ahu, i, ohu, ptu, y* etj.:

Pasthirrma që shprehin pakënaqësi, keqardhje, mërzi, dhimbje: *a, ah, e, eh, of, oi, uf* etj.:

## **2. Psthirrat nxitëse**

Pasthirra që shprehin thirrje: *ej(hej), o, ore (or, mor, more), moj (ori, mori), pëst* etj.

Pasthirra që shprehin nxitje, urdhër ose lutje: *oburra, forca, hop (hopa), hë, na, sus, shët, të keqen* etj.

Pasthirra që shprehin përshëndetje të ndryshme, mirënjohje, mallkime, sharje, ngushëllime: *faleminderit, lamtumirë, mirëdita, mirëmbërëma, mirupafshim, mirë se erdhe, mirë se vjen, ditën e mirë, natën e mirë, tungjatjeta, udha e mbarë* etj.